



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2020

**Lënda:           Përgjigje kërkesë për informacion**

\_\_\_\_\_  
**Rruga \_\_\_\_\_, Tiranë**

**e.mail:** \_\_\_\_\_

Në përgjigje të kërkesës suaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me e.mail, rregjistruar me nr.2775 prot, datë 12.02.2020, dhe administruar me datë 13.02.2020, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion në lidhje me dëgjesat publike të realizuar për tre projekte, ju bëjmë me dije se:

Me Vendim të Këshillit Bashkiak Shkodër Nr. 8, datë 27.02.2014 “Për miratimin e listës së prioriteteve të investimeve sipas programeve të zhvillimit për të cilat kërkohen financime”, tek Programi i Kulturës dhe Turizmit është miratuar dhe rikonstruksioni i teatrit “Migjeni”. Rikonstruksioni i godinës së Teatrit “Migjeni” është bërë i pjesshëm, ndaj ai vazhdon të jetë në listën e prioriteteve të Investimeve sipas Programeve të Zhvillimit, për të cilat kërkohen financime. Nuk kemi të dhëna për dëgjesat publike të asaj periudhe.

Për projektin "Rikualifikimi urban i rrugicave në Qendren Historike", Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në thirrjen e bërë. Projekti është miratuar nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, mbi bazën e politikave dhe programeve të zhvillimit të rajoneve të Shqipërisë i cili përcakton edhe masën e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore.

Dëgjesa publike në lidhje me këtë projekt është bërë gjatë dëgjesave për Buxhetin e Bashkisë Shkodër vitin 2016. Informacion më të detajuar mund të gjeni në linkun [http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/buxheti\\_i\\_vitit\\_2016\\_839.pdf](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/buxheti_i_vitit_2016_839.pdf)

Projekti “Shëtitorja Velipojë” për të cilin ju kërkonti informacion i përket vitit 2014, për të cilin Bashkia Shkodër nuk ka të dhëna për dëgjesat publike të bëra nga ish komuna Velipojë.

Informacion për investimet mund të gjeni në VKB nr.82, datë 20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër” tek lista emërore e projekteve të investimeve, në linkun [http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Vendimet\\_e\\_Keshillit\\_169\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Vendimet_e_Keshillit_169_1.php)

Njoftimet për këshillim me publikun për rikonstruksionin e rrugëve në Velipojë Plazh, mund ti gjeni në

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/N\\_J\\_O\\_F\\_T\\_I\\_M\\_per\\_keshillim\\_me\\_publikun\\_12\\_20\\_1.ph](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/N_J_O_F_T_I_M_per_keshillim_me_publikun_12_20_1.ph)

Të gjitha njoftimet për këshillim me publikun, Bashkia Shkodër i publikon në linkun

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Keshillim\\_me\\_Publikun\\_301\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Keshillim_me_Publikun_301_1.php)

Mbetemi në kontakt për çdo paqartësi

**KRYETAR**

\_\_\_\_\_  
**Voltana ADEMI**